



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave-KRM "Pastrimi" Sh.A të datës 11.01.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2023, të miratojë këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KOMPANISË RAJONALE TË MBETURINAVE "PASTRIMI"SH.A

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 17,760.00 € (shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë euro), për ta mbështetur financiarisht përkatësisht subvencionuar pjesërisht –pagesën e borxhit që ka KRM "Pastrimi" ndaj Kreditorit KMDK Sh.A, konform dispozitave të Vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave-KRM "Pastrimi" Sh.A të datës 11.01.2023 .

II. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfere të planifikuara për vitin 2023 në xhirollogarinë bankare të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave " Pastrimi"SH.A .

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

IV. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozimin- Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave-KRM "Pastrimi" Sh.A të datës 11.01.2023.

Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Propozim - Vendimi bëhet për ta mbështetur financiarisht përkatësisht subvencionuar pjesërisht –pagesën e borxhit që ka KRM "Pastrimi" ndaj Kreditorit KMDK Sh.A, konform dispozitave të Vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave-KRM "Pastrimi" Sh.A të datës 11.01.2023

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 352/01-2873
Lipjan, më 16.01.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Komisioni Komunal i Aksionarëve, në mbledhjen e dt 11.01.2023 pas dakordimit të përgjithshëm dhe duke u bazuar nga kometencat nga Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëri Tregtare dhe Ligji Nr. 03/L-087 për Nderrmarje Publike, me datë 11.01.2023, propozon dhe aprovon këtë :

V E N D I M

I . Lejohet subvencionimi – pagesa e borxhit ndaj Kreditorit KMDK Sh.A, në vlerë prej 20% nga borxhi i përgjithshëm i KMDK-së.

II. Komunat dakordohen që subvencionimin ta bejne ne bazë të logaritjes së borxhit te pergjithsëm për vitin 2022, si në vijim:

- Komuna e Prishtinës – 56% apo në shumë prej 112,760.00 euro;
- Komuna e Fushë Kosovës – 12.45% apo në shumë prej 24,900.00 euro;
- Komuna e Podujevës – 10.32% apo në shumë prej 20,640.00 euro;
- Komuna e Lipjanit – 8.88% apo në shumë prej 17,760.00 euro;
- Komuna e Drenasit – 6.66 % apo në shumë prej 13,320.00 euro;
- Komuna e Obiliqit – 5.25% apo në shumë prej 10,500.00 euro.

II Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit të vendimit respektivisht nënshkrimit nga Aksionarët e Komunave të lartëcekura dhe i njejt i do ti dergohet Kryesuesit të Komunës dhe Kryetarve të Komunave .

A r s y e t i m

Komisoni Komunal i Aksionarëve duke shqyrtuar si kërkesë urgjente për subvencionim të borxhit ndaj KMDK-së në vlerë prej 20% si në pikën I të këtij vendimi, ka arritur dakordim të përgjithshëm se kjo vlerë e mjeteve ndikon në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në ndërmarrje. Prandaj është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Iu dërgohet:

-KRM "Pastrimi" Sh. A

-Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe Kryetarëve të Komunave,

-Arkivës

Lista e nënshkrimeve të aksionarëve të KRM "Pastrimi":

1. Shegë Beqiri
2. Bekim Brestovci
3. Muhamet Selmani
4. Mimoza Abdullahu
5. Bahri Selimi
6. Ilir Hasani
7. Habib Mekolli
8. Lumnije Krapci
9. Ardit Cani
10. Fadil Sopa
11. Valon Pacolli
12. Abdurrahman Krasniqi
13. Fidan Ahmeti

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

